



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300417/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda : Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarlatin e Policisë Lushnje.

Drejtuar: **Z. Taulant BALLA**
Ministër i Brendshëm

TIRANË

Z. Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Lorenc PANGANIKA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

FIER

Z. Agim BASHA
Shef i Komisarlatit të Policisë

LUSHNJE

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi inspektimin periodik që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisarlatin e Policisë Lushnje.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisarlatin e Policisë në Lushnje.

Inspektimi u krye në datën 10.05.2023, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria

Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Besnik Deda me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Rendit të Policisë në Lushnje, z. Çelaj i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Çelaj informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisariati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisariati.

Grupi i inspektimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga informacioni i punonjësve të komisariatit, si dhe nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹, rezultoi se:

- Nuk ishin marrë masat për ndërtimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarariat e Policisë Lushnje, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, femrat, dhe të miturit.
- Nuk ishin marrë masat për ndërtimin dhe vënien në funksionim të ambienteve të reja të sigurisë sipas kritereve të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe në procedurën standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.
- Nuk ishin marrë masat për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në mjediset e brendshme të Komisarariatit, në ambientin e shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar në mjediset e këtij komisariati.
- Nuk ishin marrë masat për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
- Nuk ishin marrë masa për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisarariat dhe vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar.
- Nuk ishin marrë masat për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- Nuk ishin marrë masat për lyerjen dhe mirëmbajtjen e dhomës së shoqërimit.
- Nuk ishin marrë masat për identifikimin e përgjegjësive për mos plotësimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga vizitat inspektuese të zhvilluara ndër vite në Komisarariat e Policisë në Lushnje.

¹ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I79-2 prot., datë 12.12.2022.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

- **Ishin marrë masat** për vendosjen e orës së vënies nën mbikëqyrje policore në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, për personat e shoqëruar në organet e policisë dhe jo orën e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo orën kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Kërkesat e bëra nga Komisariati i Policisë Lushnje drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Fier për vitin 2023 kishin të bënin vetëm me regjistrat për Seksionin e Rendit në Komisaratin e Policisë Lushnje.² Avokati i Popullit vlerëson se drejtuesit kanë pasur kohë të mjaftueshme për të bërë kërkesat buxhetore për të përmirësuar situatën të paktën për disa rekomandime, por nuk e kanë bërë këtë gjë duke treguar mungesë bashkëpunimi dhe vlerësimi të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Lushnjë, gjendja ishte përkeqësuar në krahasim me inspektimin e radhës, vazhdonin të ishin të pranishme mjaft problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisaratin e Policisë Lushnje **nuk ka ambiente shoqërimi**³ kusht ky i parashikuar në ligjin nr. 108/2014, “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gra, meshkujt madhorë dhe të miturit.⁴

Theksojmë, se qyteti është me rëndësi dhe ka nevojë urgjente që ambientet e komisarimit të jenë në kushte të përshtatshme për të bërë të mundur funksionimin e policisë në standardet e kërkuara.

Përgjatë inspektimit konstatuam se Komisariati i Policisë Lushnjë **nuk kishte dhoma shoqërimi**, sipas komunikimit me shefin e rendit u informuam se personat e shoqëruar kalonin menjëherë në dhomat e punës të oficerëve të policisë dhe në raste të tjera

² Shkresa nr. 206 prot.datë 17.01.2023, me lëndë “Kërkesë”.

³ Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisarateve dhe stacioneve të policisë.

Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave të jenë të lyera, të pastra nga ana higjienike si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme. Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

⁴ *Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

kalonin në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier. Ambienti i shoqërimit që përdorej më herët për shoqërimin e burrave madhorë, aktualisht ishte kthyer në zyrë në funksion të stafit.

Në këtë Komisariat **nuk kishte sistem monitorimi me kamera** për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve. Gjatë kohës së kryerjes së inspektimit, nuk kishte persona të shoqëruar.

U konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Ndërkohë një kopje e këtij procesverbali ruhej në sekretarinë e institucionit.

Sa më sipër përbën një situatë të paprecedentë dhe Avokati i Popullit kërkon marrjen e masave urgjente për sjelljen e kushteve në këtë komisariat në përputhje me ligjin.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në zbatim të ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar dhe në procedurën standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019, çdo njësi policore duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Lushnje, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurën standarde: “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Në rubrikat e regjistrit konstatuam mungesën e plotësimit me saktësi të rubrikës “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/ të afërmeve*” ku në pjesën më të madhe ishte shkruar se refuzon njoftimin, ndërkohë që edhe në rastet ku ishte shkruar emri i personit që njoftohet, nuk

ishite shkruar as numri i kontaktit të personit që njoftohet dhe as ora e njoftimit⁵. Numri i të shoqëruarve për vitin 2023 ishte 168 persona nga të cilët 13 të mitur dhe 4 gra.

Gjithashtu, në këtë Komisarariat administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar.

Në këtë komisarariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar. Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyronin edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa nëse kishin të tilla.

Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve.

Në Komisariatin e Policisë Lushnje nuk kishte ambiente të sigurisë pasi ato ishin mbyllur në përputhje me rekomandimet e mëparshme të institucionit të Avokatit të Popullit dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier.

Ambientet e intervistimit

Në godinën aktuale në Komisariatin e Policisë Lushnje oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të CPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon

⁵ *Kreu VII, procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.*

MKPT-ja në drejtoritë dhe komisariatet e policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar⁶.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Gjithashtu, Komisariati i Policisë Lushnje në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

Një problematikë e konstatuar nga grupi i inspektimi, kishte të bënte edhe me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë të shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018-të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë⁷. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të

drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisariatit. Sa më sipër është një praktikë si rezultat i të cilës humbet qëllimin për të cilën jepet karta e të drejtave.

⁶ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

⁷ Komiteti European për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28⁷.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të⁸.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Në Komisaratin e Policisë Lushnje nuk kishte ndonjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar duke mos e konsideruar të mjaftueshme sa më sipër, kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre, të garantuara nga ligji.

⁸ CPT ka rekomanduar se duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta për t'u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrestuar pa vonesë. CPT ka rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluarit/ arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasim me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë e drejtë. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.21]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme **për vënien në parametra ligjorë** të infrastrukturës policore në Komisariatin e Policisë Lushnje.
2. Ndërtimin e ambienteve të përshtatshme sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për personat e rritur, femrat, dhe të miturit.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në mjediset e brendshme të Komisarariatit, si dhe në çdo ambient për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar në mjediset e këtij komisaritati.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

5. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të të gjitha rubrikave të regjistrit sipas kërkesave të parashikuara në procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit.
8. Drejtori i Drejtorisë Vendore Fier të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive për mos zbatimin e rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, dhe komunikimi në vijim të masave të marra në lidhje me to.
9. Informimin e Avokatit të Popullit për masat e marra dhe kohën e nevojshme për zbatimin gradual të tyre sipas mundësive buxhetore.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

Konc.:
G.Çarkaxhiu